



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 235/8 Prot.

Pogradec, më 21 . 01 . 2022

VENDIM

Nr. 05 datë 20.01 2022

"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË FAMILJES SË Z.SHABAN HOXHALLARI QË DO TË VAZHDOJË PROCEDURËN E PRIVATIZIMIT TË BANESËS SHTETËRORE QË KA MBETUR PAPRIVATIZUAR"

Mbështetur në Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", gjithashtu dhe në zbatim të VKM Nr.179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të Ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërrmarjeve shtetërore", dispozitat e të cilit përcaktojnë procedurën e privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara, dhe VKM NR.898 , datë 18.11.2020 "RREGULLAT , KUSHTET , KRITERET E PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESE TË PAPRIVATIZUARA", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së familjes së mëposhtme për vazhdimin e procedurës së privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara.

Emri Mbiemri	Adresa	Dokumentacioni për plotësim	Procedura e privatizimit
SHABAN HOXHALLARI	Rr."Rinia", Pall.161, Shk.2,Ap.10	Formular 1 ,2 ,3 Kontratë Shit-Blerje	Pagesa është kryer, Nënshkrim Kontrate

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

KRYETAR I KESHILLIT

Sotiraq MANGËR

